



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë më, 18.06.2020

**NJOFTIM**

Me Urdhërin nr. 250, datë 17.06.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si dhe mbështetur në, VKM nr. 426, datë 01.06.2020 Për një ndryshim në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002, të këshillit të ministrave, “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, njoftojmë , si më poshtë:

1. Shfuqizimin e Urdhërit nr. 154 datë 27.03.2020 ‘Për Pezullimin e të gjithë afateve administrative ndaj Aplikantëve’ njoftuar nëpërmjet publikimit të njoftimit datë 27.03.2020 në faqen zyrtare të AZHBR.
2. Rifillimin e të gjithë afateve administrative, që kanë aplikantët/përfituesit të programit IPARD II, thirrja 1 dhe 2.  
Për të gjitha shkresat e reja që do të dërgohen aplikantëve/përfituesve, numërimi i afateve do të llogaritet sipas parashikimeve në Udhëzuesin për Aplikantët.
3. Numërimi i afateve administrative, do të rifillojë nga data 23.06.2020.
4. Kërkesat apo dokumentat përkatëse dorëzohen me postë në adresën:

**Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural,  
Rruga Muhamet Gjollësja, nr.56,  
Tiranë**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**